

**PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË  
GRAVE NË KOMUNËN E KËRÇOVËS**

2016-2017

**ЛОКАЛЕН АКЦИСКИ ПЛАН ЗА ЕКОНОМСКО ЈАКНЕЊЕ  
НА ЖЕНИТЕ ВО ОПШТИНА КИЧЕВО**

2016-2017

**LOCAL ACTION PLAN FOR ECONOMIC EMPOWERMENT  
OF WOMEN IN THE MUNICIPALITY OF KICEVO**

2016-2017



## **Plani lokal i veprimit për fuqizimin ekonomik të grave në Komunën e Kërçovës 2016-2017**

Projekt financiarisht i mbështetur nga:  
Ambasadës e Britanike në Shkup

Projekti i realizuar nga:  
Iniciativa Qytetare e Femrave ANTIKO

**Shkup, Nëntor 2015**

Ambasada Britanike në Shkup ka mbështetur përgatitjen e këtij publikimi në kuadër të projektit “Fuqizimi ekonomik i grave në dy komuna”. Përmbajtja e këtij materiali nuk pasqyrojnë domosdo qëndrimet apo mendimet e Ambasadës Britanike në Shkup.

Publikim:

Plani lokal i veprimt për fuqizimin ekonomik të grave në Komunën e Kërçovës 2016-2017

Botues:

Iniciativa qytetare e femrave ANTIKO

Rr.„Vukovarska“ 23-1/2

1000, Shkup

P.O.Box 1090/1010

Tel: + 389 (0)2 2614 641; + 389 (0)2 2611 130

e-mail: antico@t-home.mk; contact@antiko.org.mk

www.antiko.org.mk

Facebook: WCI.ANTIKO

Twitter: WCI\_ANTIKO

Redaktor:

Gjyner Nebiu

Irina Hadji Mitova

Përkthimi dhe lektorimi në shqip:

Bashkim Bakiu

Përkthimi dhe lektorimi në anglisht:

Daniela Brajkovska

Dizajni, përgaditja teknike dhe shtypi:

Magna Sken Shkup

Tirazhi:

150 egzemplar

Tirazh që jepet falas/ jokomercijal

**Listë e shkurtesave:**

APRM- Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë

LMB – Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave

KMB – Komisioni për mundësi të barabarta të grave dhe burrave

MPPS – Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

PVKBGj – Plani i veprimit kombëtar për barazi gjinore 2013-2016

## 1. HYRJE

Maqedonia është shtet demokratik e social, në të cilën të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, ndaj një nga vlerat themelore të saj është respektimi i parimeve demokratike dhe të drejtave të njeriut të të gjithë qytetarëve të saj. Pozita juridike dhe statusi i grave në Republikën e Maqedonisë janë të rregulluar me Kushtetutë - si akt më i lartë juridik në vend, si dhe në shumë ligje në të cilat është inkorporuar perspektiva gjinore. Përveç me legjislacionin e brendshëm, këto çështje janë rregulluara edhe me marrëveshje ndërkombëtare të cilat Republika e Maqedonisë i ka nënshkruar dhe ratifikuar, e të cilat, sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, janë pjesë e sistemit tonë juridik.

Korniza juridike për barazi gjinore

Maqedonia ka një kornizë solide ligjore dhe strategjike për promovimin dhe mbrojtjen e mundësive të barabarta, kurse të një rëndësie të veçantë janë: Ligji për mundësi të barabarta për burrat dhe gratë, Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, Kodi Zgjedhor, si dhe Ligji për marrëdhënie pune, i cili është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin e fuqizimit ekonomik të grave dhe reduktimin e varfërisë dhe shkallës së lartë të papunësisë në mesin e grave.

Duhet të theksohet edhe sjellja e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2013-2020, e miratuar nga Parlamenti i Republikës së Maqedonisë në të cilën janë përcaktuar prioritetet strategjike sipas sferave dhe Plani kombëtar i veprimit për Barazi Gjinore 2013-2016, i cili ndër të tjera i përcakton edhe objektivat strategjike specifike për përmirësimin e nivelit të barazisë gjinore në sferat prioritare tematike.

Mekanizmat kombëtarë për avancimin e barazisë gjinore në Republikën e Maqedonisë

Republika e Maqedonisë ka vendosur mekanizma kombëtarë për mundësi të barabarta të grave dhe burrave në nivel qendror dhe lokal. Në nivel kombëtar, MPPS është ministria përgjegjëse, në kuadër të së cilës drejtpërdrejt përgjegjës janë Sektori për mundësi të barabarta dhe këshilltari shtetëror për mundësi të barabarta.

Njëherësh, në MPPS, sipas LMB, ka një nëpunës shtetëror- përfaqësues juridik për të provuar trajtimin e pabarabartë në bazë të gjinisë, i cili ka për detyrë të kryejë procedurë për mbrojtje nga diskriminimi në bazë të gjinisë për veprimet e ndërmarra nga subjektet në sektorin publik, por dhe në atë privat, në përputhje me nenin 3 të Ligjit në fjalë.

Sipas LMB (Ligjit për mundësi të barabarta) në të gjitha ministritë nga radhët e nëpunësve civilë ka të emëruar nga një koordinator dhe zëvendës koordinator për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, të cilët me ligj i kanë të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë, ku janë përgjegjës për aplikimin e perspektivës gjinore në ministrinë përkatëse për zbatimin e Strategjisë dhe të gjitha dokumenteve tjera strategjike nga sfera e barazisë gjinore. Ata për aktivitetet e ndërmarra kanë për obligim të dorëzojnë raport vjetor në MPPS. Në kuadër të strukturës së mekanizmave kombëtarë për barazi gjinore, rol të rëndësishëm luan edhe Komisioni për Mundësi të Barabarta për Gratë

dhe Burrat në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë. Së bashku me Klubin e deputeteve, këto organe paraqesin mekanizma për zbatimin e perspektivës gjinore në organin më të lartë ligjvënës për krijimin e politikave dhe vendimmarrjen.

Mekanizmat gjinorë në nivel lokal në kuadër të institucioneve janë të përbërë nga strukturat e mëposhtme: Komisioni për mundësi të barabarta të grave dhe burrave (në kuadër të këshillave të qeverisjes vendore, të përbërë nga këshilltarë me mandat 4 vjeçar) dhe koordinatorët për mundësi të barabarta për gratë dhe burra (nëpunësit shtetërorë). Duhet të theksohet se legjislacioni parashikon një rol të rëndësishëm për qeverisjen vendore në përpjekjet për të promovuar barazinë gjinore.

Edhe përkundër vendosjes së kornizës ligjore dhe mekanizmave për barazi gjinore, megjithatë, në realitet ekziston një hendek i madh midis barazisë së deklaruar ligjore dhe pozitës reale të gruas në shoqëri. Kundrejt progresit të arritur, gratë mbesin në gjendje jo të lakmueshme në krahasim me meshkujt në shumë sfera. Një nga sferat më të rëndësishme në të cilën dallimet në pozitën e burrave dhe grave mbetet e rëndësishme është ekonomia: gratë ballafaqohen me qasje të vështirësuar dhe shpesh përballen me diskriminim në bazë të gjinisë në tregun e punës.

Duke pasur parasysh rëndësinë e fuqizimit të pozitës ekonomike të gruas për arritjen e barazisë afatgjatë gjinore dhe të qëndrueshme, Iniciativa qytetare e grave ANTIKO e ka realizuar projektin “Fuqizimi ekonomik i grave në dy komuna” në bashkëpunim me Komunën e Manastirit dhe atë të Kërçovës, projekt ky i financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Maqedoni. Qëllimi kryesor i projektit është të dizajnohet një model dhe të ndërmerret një qasje participuese në formë të pilot projekti që do të bazohet në dëshmi në krijimin e politikave efektive për fuqizimin ekonomik të grave.

**Ky synim del drejtpërdrejt nga APFBZhR, synimi strategjik 2.3: Pilot politika të vendosura për tejkalimin e barrierave/pengesave dhe rritja e punësimit të grave,** posaçërisht në arritjen e rezultateve të parashikuara, si vijon: 2. Qasje dhe kushte të përmirësuar për gratë në fillimin dhe zhvillimin e sipërmarrësisë, 3. Qasje e përmirësuar e grave në politikat për punësim, 4. Eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit në bazë të gjinisë në tregun e punës.1 Projekti ka mundësuar që Komisioni për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat (KMB) i Komunës së Kërçovës, përfaqësuesit e institucioneve publike relevante, organizatat qytetare lokale, përfaqësuesit e sektorit të biznesit dhe gratë e papuna së bashku t'i identifikojnë masat e nevojshme për fuqizimin e pozitës ekonomike të gruas në Komunën e Kërçovës. Rezultat i këtyre përpjekjeve dhe aktiviteteve të përbashkëta është ky plan veprimi lokal për fuqizimin e grave në Komunën e Kërçovës për periudhën kohore 2016-2017.

## **2. METODOLOGJIA PËR ZHVILLIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË GRAVE NË KOMUNËN E KËRÇOVËS**

Plani i veprimit është hartuar në një mënyrë pjesëmarrëse, me përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në përcaktimin e gjendjes faktike edhe në zhvillimin dhe planifikimin e masave për përforsimin e pozitës ekonomike të grave në komunë.

Para përgatitjes së Planit të Veprimit, gjendja faktike në Komunën e

Kërçovës u identifikua përmes hulumtimeve gjithëpërfshirëse, në bazë të tri burimeve të informatave:

Metoda e grupeve të fokusit është përdorur për të fituar njohuri për punën e institucioneve përkatëse lokale (komunale dhe zyrat rajonale), në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve të ndjeshme gjinore. Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile mundësoj që të perceptojnë rolin dhe potencialin e tyre për barazi gjinore, me fokus të veçantë në fuqizimin ekonomik të grave në Komunën e Kërçovës.

Nëpërmjet studimit në terren, i cili përfshiu 150 gra të papuna nga pjesët rurale dhe urbane të Komunës së Kërçovës, u fituan njohuri në lidhje me përvojat, mendimet dhe nevojat e vetë grupit të synuar.

Burimi i tretë janë informatat sekondare, gjegjësisht të dhënat nga studimet e mëparshme, raportet, analiza të ligjeve dhe informatave të publikuara nga institucionet kompetente.

Të gjeturat, konkluzionet dhe rekomandimet e anketës së përgjithshme janë të botuara në Raportin e hulumtimit: Mundësitë dhe pengesat e përfshirjes së grave në tregun e punës të Komunës së Kërçovës, të dhënë si një botim të veçantë dhe bashkangjitur drejt këtij Plani lokal të veprimit.

Në hapin e ardhshëm, janë realizuar tri cikle trajnimesh me përfaqësuesit e të gjitha palëve të interesuara: krijimin e politikave të përgjegjshme gjinore dhe buxheti për autoritetet lokale, vlerësimin e ndikimit të rregullativës dhe monitorimin dhe vlerësimin e politikave publike. Si mbështetje shtesë është shtypur “Udhëzues: Politikat gjinore të përgjegjshme = drejtësi sociale”, përmbajtja e të cilit shkon në drejtim të përmirësimit të njohurive dhe aftësive në fusha që ishin lëndë e tri trajnimeve të realizuara.

Hapi i tretë ishte mbajtja e një punëtorie me pjesëmarrje për zhvillimin dhe planifikimin e planit të veprimit. Punëtorja u mbajt më tetor të vitit 2015, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve relevantë të sektorit publik, civil dhe të biznesit, si dhe përfaqësuese të grave të papuna të afta për punë. Gjetjet kryesore nga anketa e lartpërmendur janë përdorur si një hyrje për diskutim. Procesi i punës u lehtësua në një mënyrë që të lejojë përfshirjen të perspektivave të ndryshme, interesat dhe nevojat e pjesëmarrësve të cilët morën pjesë në mënyrë aktive në propozimin dhe përcaktimin e masave të nevojshme, veprimet dhe hapat. Zgjidhjet të shfaqura në Planin e veprimit lokal janë të bazuara në burimet e disponueshme lokale dhe mundësitë, ndërsa i marrin parasysh kufizimet dhe vështirësitë me të cilat aktorët e përfshirë hasin në punën e tyre të përditshme. Siç u përmendë, vëmendje e veçantë është kushtuar për përputhjen me zgjidhjet ekzistuese ligjore dhe objektivat strategjike të autoriteteve nacionale dhe lokale dhe për lidhje sinergjetike, me përpjekjet e tyre në fushën e promovimit të barazisë gjinore dhe çështje të tjera relevante.

Konsensusi i arritur dhe mirëkuptimi i ndërsjellë në përgatitjen e planit ndërmjet pjesëmarrësve nga sektorë të ndryshëm, siguron një bazë solide për zbatimin e tij të plotë dhe rrit shanset për arritjen e objektivave të përbashkëta të identifikuar.

### **3. QËLLIMET DHE AKTIVITETET PRIORITARE**

Qëllimi kryesor i këtij Plani lokal të veprimit është përforsimi i pozitës ekonomik të grave në Komunën e Kërçovës. Përforsimi i pozitës ekonomike

të grave do të kontribuojë në përmirësimin e zhvillimit të përgjithshëm socio-ekonomik të komunës. Mundësitë e barabarta dhe barazia gjinore do të mundësojë përfshirjen e grave në rrjedhën kryesore të shoqërisë dhe rritjen e kontributit të tyre për mirëqenien e përgjithshme të komunës. Pritet që Plani lokal i veprimit t'i arrijë qëllimet strategjike të mëposhtme:

### **Qëllimi i 1-rë strategjik: Qasje e lehtësuar e grave deri te tregu i punës**

Ky qëllim do të arrihet përmes aktiviteteve dhe rezultateve të mëposhtme:

#### **1.1. Dakordim më i mirë mes ofertës dhe kërkesës së tregut të punës**

Në bashkëpunim me sektorin e biznesit në rend të parë, Odën rajonale të afaristëve dhe Këshillin Ekonomik Lokal do të bëhet një analizë e kërkesës së tregut lokal të punës, pra nevojat e punëdhënësve. Në anën tjetër, në bashkëpunim me Agjencinë për punësim të Republikës së Maqedonisë (APRM) do të analizohet struktura arsimore e grave të papuna në komunë. Nga këto dy analiza do të nxirren rekomandime afatmesme dhe afatgjata për harmonizimin e ofertës dhe kërkesës në tregun lokal të punës. Përveç kësaj, KMB, organizatat e shoqërisë civile, APRM dhe sektori i biznesit do të ofrojë mundësi për ri-trajnimin, trajnime shpesh dhe trajnime të tjera profesionale që synojnë përmbushjen e atyre profesioneve dhe profileve që janë deficitare.

#### **1.2. Numër i zvogëluar i shpalljeve me elemente diskriminuese**

Punëdhënësit do të jenë të informuar në lidhje me përparësitë e punësimit në bazë të mundësive të barabarta, si një mundësi për të promovuar biznesin. Përmes shembujve praktikë do të prezantohen detyrimet ligjore për të parandaluar diskriminimin në punësim. Ky aktivitet do të kryhet në bashkëpunim me sektorin e biznesit (Odën rajonale të afaristëve) dhe Komisionin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

### **Qëllimi i 2-të strategjik: Shfrytëzim më i mirë i masave për punësim të Qeverisë të zbatuara nga APRM**

Përdorimi i masave të punësimit të qeverisë që i zbaton APRM do të inkurajohen përmes një qasje proaktive për aktorët relevantë vendorë në prezantimin e mundësive ekzistuese të grave të papuna. Fokus i veçantë do të vendoset tek gratë nga mjediset rurale. Aktivitetet do të fokusohen drejt:

#### **2.1. Shfrytëzim më i madh i masave të Qeverisë për punësim nga ana e grave**

Do të organizohen takime informative me gratë e papuna që të prezantohen mundësitë për mbështetje dhe punësim përmes APRM. Në bashkëpunim me mediumet elektronike lokale do të kryhet fushatë sensibilizuese për të nxitur punësimin e grave. Për informimin e grave nga mjediset rurale do të zbatohet metoda "derë më derë", që do ta zbatojnë ekipet e kombinuara të KMB, APRM dhe organizatave përkatëse të shoqërisë civile. Gjithashtu, në kuadër të komunës, do të krijohet një qendër e thirrjes për shërbimet informative në lidhje me punësimin e grave. Qendra e thirrjes në veçanti do të informojë njoftimet për punësim, si dhe për arsimimin dhe aftësimin profesional.

### **Qëllimi i 3-të strategjik: Numër i rritur i grave me aftësi dhe pozita udhëheqëse**

Për të arritur këtë qëllim strategjik, përpjekjet do të orientohen drejt arritjes së rezultatit të mëposhtëm:

#### **3.1. Vetëbesim i përforsuar i grave në aftësitë vetanake**



Do të organizohen ngjarje publike – tribuna për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me cilësitë dhe vlerat e grave. Në ato debate do të ftohen të marrin pjesë gra të suksesshme si model pozitiv, që do të ndajnë përvojat dhe mësimet e tyre.

3.2. Kapacitete të përforuara të grave për themelim dhe menaxhim të biznesit

Do të organizohen trajnime për zhvillimin e biznes planit, aftësitë menaxhuese dhe tema të ngjashme

**Qëllimi i 4-ët strategjik: Bashkëpunim i përmirësuar mes organizatave qytetare, komunës dhe institucioneve lokale**

Rezultati i prituri në kuadër të këtij aktiviteti është:

4.1. Koordinim i përmirësuar dhe komunikim mes strukturave lokale

KMB do të formojë dhe do të drejtojë trup koordinues multi-sektorial për zbatimin e këtij Plani lokal të veprimit. Në trupin koordinues do të përfshihen përfaqësues të tre sektorëve: publik, biznesit dhe shoqërisë civile. KMB do të organizojë takime koordinuese, ndër të tjera, për të monitoruar progresin e zbatimit të këtij plani. KMB dhe organizatat e shoqërisë civile, në bashkëpunim me palët tjera të interesuara, do të zhvillojnë dhe do të paraqesin të paktën dy paraqitje për fondet evropiane, që kanë për qëllim forcimin e pozitës ekonomike të grave në komunën e Kërçovës.

#### **4. PLANI PËR IMPLEMENTIM**

KMB do të jetë përgjegjës për zbatimin e planit të veprimit lokal për të përfuruar pozitën ekonomike të grave. Participimi, partneriteti me palët kyçe të interesuara, veçanërisht organizatave përkatëse të shoqërisë civile, si dhe transparenca do të jenë parimet udhëheqëse në planifikimin dhe zbatimin e hapave të caktuara të veprimit. Si hap i parë, KMB do të propozojë në Këshillin e komunës së Kërçovës për të miratuar planin e veprimit lokal, e cila do të lejojë alokimin e burimeve të nevojshme komunale dhe fondet financiare. Me këtë do të sigurohet korniza e nevojshme institucionale për zbatimin e planit dhe arritjen e qëllimeve. Vëmendje e veçantë gjatë zbatimit të Planit të Veprimit Lokal do t'i kushtohet koordinimit të aktiviteteve me programe të tjera ekonomike dhe programe të tjera përkatëse, si dhe përpjekjet e Komunës së Kërçovës dhe institucioneve publike lokale. Me këtë do të sigurohet një veprim sinenergetik dhe përmirësimi i arritjeve. KMB do të sigurojë transparencë dhe publicitet në zbatimin e Planit të veprimit përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me aktorët e interesuar dhe në bashkëpunim me mediat lokale.

#### **5. KORNIZA KOHORE E ZBATIMIT**

Plani lokal i veprimit për të forcur pozitën ekonomike të grave në Komunën e Kërçovës, do të zbatohet gjatë vitit 2016 dhe 2017. Dinamika kohore e aktiviteteve individuale është shfaqur në pjesën Pasqyrë e qëllimeve dhe aktiviteteve për fuqizimin ekonomik të grave, më poshtë në këtë dokument. Periudha e saktë e zbatimit të aktiviteteve specifike do të përcaktohet në bashkëpunim me aktorët e përfshirë dhe në përputhje me nevojat dhe mundësitë e grupit të synuar.

## 6. BUXHETI

Për zbatimin e Planit lokal të veprimit për të forcuar pozitën ekonomike të grave në Komunën e Kërçovës janë të nevojshme gjithsej 776.000 den. Përmbledhja e mjeteve financiare dhe burimeve të tjera të nevojshme për të zbatuar çdo aktivitet të planifikuar janë shfaqur në Pasqyrën e qëllimeve dhe aktiviteteve për fuqizimin ekonomik të grave, më poshtë në këtë dokument. Përkrah buxhetit të Komunës së Kërçovës, fondet e nevojshme do të sigurohen nga donatorët vendorë dhe ndërkombëtarë, USAID, fondeve në dispozicion të Evropës, UNDP, ambasadave të huaja në Maqedoni, FSHHM, programi CIVICA. Për atë qëllim, KMB dhe organizatat e shoqërisë civile të përfshira, do të hartojnë paraqitje për mjete (projekte). Përveç kësaj, pritet sektori i biznesit lokal, duke përfshirë Odën Rajonale të Afaristëve dhe shoqatat e tjera të biznesit dhe punëdhënësve, për të siguruar materiale dhe, në varësi të mundësive, kontribut financiar për zbatimin e planit. Burimet e nevojshme dhe mjetet financiare për zbatimin e secilit aktivitet të veçantë janë shfaqur në pjesën Pasqyrë e qëllimeve dhe aktiviteteve për fuqizimin ekonomik të grave, më poshtë në këtë dokument.

**PASQYRË E QËLLIMEVE DHE AKTIVITETEVE PËR PËRFORSIMIN EKONOMIK TË GRAVE NË KOMUNËN E KËRÇOVËS**

Qëllimi i dëshiruar	Masa të parashikuara dhe aktivitetet	Përgjegjësia	Korniza kohore	Resurset	Burime të financimit	Tregues të suksesit	Aktivitetet për monitorim të zbatimit
<b>Qëllimi i 1-rë strategjik: Qasje e lehtësuar e grave deri te tregu i punës</b>							
Dakordim më i mirë mes ofertës dhe kërkesës së tregut të punës	Analizë e nevojave të tregut lokal të punës	KMB	2 muaj janar – shkurt 2016	Kompjuter, internet, IT shërbim në komunë  Bashkëpunim me Odën rajonale afariste  30.000 den. për ekspertë të jashtëm	Buxheti i komunës  Donatorë	Analizë e hartuar dhe e shpërndarë e nevojave të tregut lokal të punës	Evaluim i aktiviteteteve të projektit  Pyetësorë në tribuna dhe punëtori  Raporte nga të gjitha anët e interesuara të dorëzuara deri te KMB
	Analizë e strukturës arsimore të grave të papunësuar	KMB APRM OQ, Grupi i vullnetarëve: Suzana Tasevska, Marjana Galimanoska, Jasmına Korunoska, Dilberka Maleska, Sanije Sadiku dhe Dijana Jovanoska	1 muaj mars 2016	Kompjuter, internet, IT shërbim në komunë  Bashkëpunim me APRM për sigurimin e të dhënave	/	Analizë e hartuar dhe shpërndarë e strukturës arsimore të grave të papunësuar	

Qëllimi i dëshiruar	Masa të parashikuara dhe aktivitetet	Përgjegjësia	Korniza kohore	Resurset	Burime të financimit	Tregues të suksesit	Aktivitetet për monitorim të zbatimit
	Aktivitetet për para-kualifikim, kualifikim shtesë dhe aftësim: - Kurse për para-kualifikim, - Kurse për soft skills, - Kurse për afarizëm dhe fillim të biznesit vetanak.	KMB OQ Oda rajonale afariste dhe sektori i biznesit (për zgjedhje të përbashkët të kandidatave për para-kualifikim)	1 vit prill 2016 – prill 2017	Hapësirë (komuna, pallati i të rinjve), kompjuterë  200.000 den. për: - trajnues të jashtëm pas lëmvive, - materiale të nevojshme për trajnim.	Komuna e Kërçovës  Kryetar  Donatorë: UNDP, USAID, Antiko  APRM	Numër i vizitorëve në kurset  Numër i vizitorëve që me sukses e kanë kryer kursin  Numër i grave që janë punësuar 2 vitet e ardhshme duke i shfrytëzuar aftësitë e fituara nga trajnimet	Evaluum i aktiviteteve të projektit  Pyetësorë në tribuna dhe punëtori  Raporte nga të gjitha anët e interesuara të dorëzuara deri te KMB
Numër i zvogëluar i shpalljeve me elemente diskriminuese	Organizim i tribunës për informim të sektorit të biznesit për përparësitë e punësimit të bazuar në mundësitë e barabarta	KMB Këshilli ekonomik lokal	1 muaj janar 2016	Hapësirë (komunë)  15.000 den. për koktejt, materiale dhe trajnues (shpenzime rrugore)  Trajnues nga Komisioni për mbrojtje dhe parandalim të diskriminimit	Komuna e Kërçovës  Oda rajonale afariste	Numër i pjesëmarrësve në tribunë	

Qëllimi i dëshiruar	Masa të parashikuara dhe aktivitetet	Përgjegjësia	Korniza kohore	Resurset	Burime të financimit	Tregues të suksesit	Aktivitetet për monitorim të zbatimit
<b>Qëllimi i 2-të strategjik: Shfrytëzim më i mirë i masave për punësim të Qeverisë të zbatuara nga APRM</b>							
Shfrytëzim më i madh i masave të Qeverisë për punësim nga ana e grave	Takime informative me gra të papunësuar	APRM Organizata qytetare KMB Këshilli ekonomik lokal	Në vazhdimësi janar 2016 – dhjetor 2017	Hapësirë, duke kyçur mjediset rurale  Material informativ (liflet etj.): 30.000  Prezantues të masave	Komuna e Kërçovës  APRM	Janë të mbajtura 8 takime (me dinamikë kuartale)  Numër i pjesëmarrësve  Numër i fletushkave të hartuara dhe të shpërndara	Evaluum i aktiviteteteve të projektit  Raporte për emetim të spoteve në TV dhe radio (kliping mediu mesh)  Raporte nga të gjitha anët e interesuara të dorëzuara deri te KMB
	Fushatë në media për nxitjen e punësimit të gratë	APRM Organizata qytetare KMB Media lokale	Në vazhdimësi janar 2016 – dhjetor 2017	Prezencë në mediat lokale elektronike  Përpilim i spotit promotiv në radio: 25.000 den.  Hartim i spotit promotiv në TV: 50.000 den.  Emetim pa pagesë në TV dhe radio faqet	Komuna e Kërçovës  Sektori i biznesit  Donacione  Media lokale elektronike	Numër i emisioneve  Numër i emetimeve të spotit në TV  Numër i emetimeve të spotit në radio	

Qëllimi i dëshiruar	Masa të parashikuara dhe aktivitetet	Përgjegjësia	Korniza kohore	Resurset	Burime të financimit	Tregues të suksesit	Aktivitetet për monitorim të zbatimit
<b>Qëllimi i 2-të strategjik: Shfrytëzim më i mirë i masave për punësim të zbatuara nga APRM</b>							
	Formimi i ekipeve për informim, "nga dera në derë", të grave nga rajonet rurale për masat aktive për punësim dhe për përkrahje të bujqësisë	KMB APRM Organizata qytetare	Në vazhdimësi janar 2016 – dhjetor 2017	Hapësirë në mjediset rurale Ekipte të formuara nga OQ, me përkrahje financiare për transport, telefon, materiale të printuara – 90.000 den.	Komuna e Kërçovës Donatorë	Të realizuara së paku 12 vizita në terren (nga një në muaj)	Raporte nga vizitat në terren të skuadrave të formuara për informim, dorëzuar deri te KMB
	Formimi i Call – qendrës në komunë për shërbime informative të lidhura me mundësitë për punësimin e grave të papunësuar	Komuna e Kërçovës, në propozim të KMB APRM	Në vazhdimësi 2016 – 2017	2 persona të punësuar nga komuna (ose të angazhuar në mënyrë plotësuese) 240.000 den. komuna (ose 10.000 den. në muaj) Hapësirë, kompjuter, telefon	Komuna e Kërçovës Donatorë	Numër i paraqitjeve nga gratë e papunësuar Numër i grave të informuara	Raporte mujore nga koll-qendra, të dorëzuara deri te KMB

Qëllimi i dëshiruar	Masa të parashikuara dhe aktivitetet	Përgjegjësia	Korniza kohore	Resurset	Burime të financimit	Tregues të suksesit	Aktivitetet për monitorim të zbatimit
<b>Qëllimi i 3-të strategjik: Numër i rritur i grave me aftësi dhe pozita udhëheqëse</b>							
Vetëbesim i përforcuar i grave në aftësitë vetanake; Kapacitete të përforuara të grave për themelimin dhe menaxhim të biznesit	Organizimi i tribunave në të gjitha BV dhe BU për rritjen e vetëdijes për cilësitë dhe vlerat e grave, me pjesëmarrje të grave të suksesshme – shembuj pozitivë; Organizimi i trajnimeve për zhvillimin e biznes planit, aftësitë menaxhuese dhe tema të ngjajshme	Kryetare e KMB	6 muaj nëntor 2016 - prill 2017	Automjetet 36.000 den. për trajnues dhe materiale (ftesa, koktej, materiale pune etj.)  Hapësirë dhe teknikë	Komuna e Kërçovës  donatorë	6 tribuna me 30 pjesëmarrëse secila	Raportet nga tribunat, dorëzuar deri te KMB

Qëllimi i dëshiruar	Masa të parashikuara dhe aktivitetet	Përgjegjësia	Korniza kohore	Resurset	Burime të financimit	Tregues të suksesit	Aktivitetet për monitorim të zbatimit
<b>Qëllimi i 4-ët strategjik: Bashkëpunim i përmirësuar mes organizatave qytetare, komunës dhe institucioneve lokale</b>							
Kordinim i përmirësuar dhe komunikim mes strukturave lokale	Formimi i trupit të përbashkët koordinues për zbatimin e këtij Plani veprimi	KMB	2 muaj janar – shkurt 2016	Hapësirë	/	Trup i përbashkët koordinues i formuar	Raport për formimin e trupit (KMB)
	Organizimi i takimeve tremujore koordinuese të palëve të interesuara	KMB	Në vazhdimësi mars 2016 – dhjetor 2017	Hapësirë, koktej	Komuna e Kërçovës (si nikoqire e takimeve)	së paku 7 takime të mbajtura koordinuese	Raportet nga takimet e mbajtura koordinuese (KMB)
	Përgatitja e propozim-projekteve të përbashkëta mes sektorit qytetar dhe publik për mundësi të barabarta	KMB, Organizata qytetare	Në vazhdimësi mars 2016 – dhjetor 2017		2 x 30.000 den. për 2 ekspertë të jashtëm për përgatitje të aplikimit për fonde të UE-së	Së paku 2 aplikime të përbashkëta për fonde të UE-së të komunës dhe organizata relevante qytetare të grave	2 aplikime të parashtruara (KMB dhe organizata qytetare)



## Women's Civic Initiative ANTIKO

„Vukovarska“ 23/1-2, 1000 Skopje  
P.O. Box 1090/1010

Tel: ++ 389 (0)2 2 614 641; ++ 389 (0)2 2 611 130  
e-mail: [antico@t-home.mk](mailto:antico@t-home.mk) ; [contact@antiko.org.mk](mailto:contact@antiko.org.mk)

[www.antiko.org.mk](http://www.antiko.org.mk)

Facebook: WCI.ANTIKO

Twitter: WCI\_ANTIKO



British Embassy  
Skopje



Женска граѓанска иницијатива  
Initiative qytetare e femijare  
Women's Civic Initiative

